

ARTICLES OF ASSOCIATION
OF
LVM Real Estate Investments Sh.p.k.
(the "Company")

Article 1

Name, Form of the Company, Company Seat and Financial Year

- 1.1 The name of the Company is LVM Real Estate Investments Sh.p.k..
- 1.2 The Company is incorporated in the form of the limited liability company, in accordance with Law 9901/2008 "On entrepreneurs and commercial companies", as amended ("**Albanian Commercial Law**").
- 1.3 The seat of the Company is located at the address: **Boulevardi "Gjergj Fishta", Building 32, Entrance 14, Ap. 8, Tirana, Albania** [the "Company seat").
- 1.4 The financial year of the Company begins on January 1st and ends on December 31st of each calendar year.
As a matter of exception, the first financial year commences upon the registration of the Company with the National Business Center and ends on December 31st, 2022.

Article 2

Company Object

- 2.1 The Company's object shall be the following:
- a) purchase, sale, lease and development of real estate properties;
 - b) any other lawful activity.
- 2.2 The Company is entitled to undertake all actions and measures which are directly or indirectly suitable to serve the Company's object, including but not limited to the establishment or acquisition of all kind of companies, participation in Albanian or foreign companies or joint ventures or various types of businesses having the same or similar object.
- 2.3 The activities requiring for relevant permits, licenses and/or approvals shall be carried out after obtaining such permits, licenses and/or approvals.

Article 3

Share capital, Shares and Sole Shareholder

- 3.1 The initial share capital of the Company amounts to EUR 500,000.00 (five hundred thousand) equal to ALL 60.530.000,00 (sixty million five hundred and thirty thousand) as per Bank of Albania exchange rate published on 09.12.2021/at 12:00:39 pm (1 Euro = 121,06 ALL) and consists of 1 (one) quota.
- The initial share capital will be paid in cash within 6 months after the registration of the Company with the National Business Center.
- 3.2 The Sole Shareholder of the Company is W E - International Zweite GmbH, a limited liability company, organized and existing in accordance with the Laws of Germany,

registered with the Commercial Register, District Court Stuttgart, with no. HRB 776225, having its registered office at the address: Stiftsbergstrasse 1, 74172 Neckarsulm, Germany.

3.3 Based on a Sole Shareholder's resolution the share capital may be increased by increasing the nominal amount of the existing share or any other way permitted by law.

3.4 Contribution for shares may be monetary or non-monetary. Monetary contributions shall be paid into the bank account of the Company. The non-monetary contributions are evaluated by a decision of the Sole Shareholder.

Article 4 Duration of the Company

The Company is set up for an unlimited period.

Article 5 Administrators and Representation

5.1 The Company has 2 (two) administrators appointed by the Sole Shareholder. The Company shall be represented by the 2 (two) administrators jointly.

The first administrators of the Company for a period of 4 (four) years, from 10.12.2021, are the following:

- **Mr. Boris Lozić**, Croatian citizen, son of Hrvoje, born on 26.09.1978, in Zlosela, Bosnia and Herzegovina, holder of the passport with no. 287162801 and personal number 84889031881; and
- **Mr. Dalibor Bošnjak**, Croatian citizen, son of Marko, born on 05.04.1977, in Linz, Austria, holder of the passport with no. 145683301 and personal number 06005766907.

5.2 The Administrators manage the business affairs with the diligence of a prudent businessman and work, in good faith and in the best interests of the Company. They shall observe in particular the provisions of these Articles of Association, the provisions of the managements' rules of procedure, the resolutions of the Sole Shareholder, the provisions set out in their employment contracts and the directives issued by the Sole Shareholder.

5.3 The administrators may jointly authorize by virtue of a power of attorney any third party to represent the Company and sign any document in the name and on behalf of the Company. In such cases, in order for the transaction to be valid, a second signature of any of the 2 (two) administrators shall be deemed necessary.

Article 6 The Sole Shareholder

6.1 The Sole Shareholder is responsible for the highest decision-making process of the Company.

6.2 The Sole Shareholder may be represented by advisors or lawyers who have undertaken to maintain professional confidentiality, on the basis of a written authorization.

6.3 Resolutions taken by the Sole Shareholder shall be recorded in meeting minutes, and signatures on respective minutes are certified in case notarization is required by statutory provisions.

6.4 The Sole Shareholder shall pass resolutions in the matters provided for by law and in these articles of association and also if the interests of the Company require this, to the extent it is in compliance with Albanian Commercial Law. The Sole Shareholder shall decide on the following matters:

- a) Approval of the annual activity performance report and the annual financial statements, and discharge of the administrators;
- b) selection of a competent auditor qualified to audit the balance sheet and annual reports;
- c) decision on the disposition of profit and loss cover;
- d) decisions on the increase and reduction of share capital as well as the creation, intended use and distribution of capital and revenue reserves;
- e) sale or lease of the Company's assets and determination of the rights to use it;
- f) amendments of the Articles of Association, and on adoption and amendments of partnership agreements/bylaws;
- g) change of the Company's name, seat and object;
- h) merger, division or transformation of the Company;
- i) winding up of the Company;
- j) appointment and dismissal of the directors and officers of the company;
- k) preparation and amendment of the rules of conduct for the management;
- l) purchase and sale of companies or parts of companies;
- m) foundation and winding-up of subsidiaries and purchase, sale and takeover of company shares;
- n) passing of shareholder resolutions for subsidiaries of the Company and authorization of a representative in general meetings where the Company is a Shareholder, with regard to issues for which a shareholder decision of the Company is required- by law;
- o) representation of the Company in courts and in other proceedings against the administrators;
- p) any other issue set out in the Albanian Commercial Law.

6.5 The administrators should require the express prior approval of the Sole Shareholder in the form of a written resolution in order to undertake the transactions listed below:

- a) acquisition and/or sale of the title or perpetual usufruct right to, or heritable building right on land, including the conclusion of corresponding pre-contracts; exceptions

to this are the acquisition of land and buildings for the opening and operation of a store if the planned total investment costs per site do not exceed the national currency equivalent of EUR 10,000,000.00 (ten million), and the sale of land whose area does not exceed 10,000 m² (ten thousand square meters);

- b) encumbrance of property, especially with usufruct, easements, mortgages or land charges, excluding encumbrances (including the provision of securities) within the scope of the ordinary course of business; especially, the ordinary course of business includes the encumbrance of land in order to
 - close loan contracts related to the business needs of the company,
 - comply with undertakings from purchase agreements or from a construction permission to build a store,
 - grant standard easements or other standard rights for use for public or private sector utilities (e.g. for gas, water and electricity supply, telecommunication);
- c) the execution of any action that is related to the purchase and sale of companies or parts of companies;
- d) the execution of any action that is related to the foundation and winding up of companies and purchase, sale and takeover of company shares;
- e) conclusion, amendment and termination of company agreements, including controlling and profit-and-loss transfer agreements and other similar agreements under company law (e.g., trust agreements);
- f) provision of loans, assumption of guarantees, warranties and other liabilities, except in favour of companies of the Schwarz Group; the provision of advances to employees is also excepted;
- g) undertaking any necessary actions regarding the implementation of decisions on granting of profit participation;
- h) granting of retirement provisions, disability provision or provisions for surviving dependents to employees;
- i) execution of any action that is related to resolutions for subsidiaries according to Article 6.4 a) to k) and upon obtaining all the necessary prior approvals according to this Article.

Article 7 Register of Decisions

All decisions taken by the Sole Shareholder shall be registered in the Register of Decisions, the data of which may not be changed or otherwise altered.

**Article 8
Financial Statements**

- 8.1 After the end of the financial year, the administrators shall immediately prepare the financial statements and shall submit statements to the auditor, and jointly with the auditor's report shall submit them to the Sole Shareholder for approval. The Sole Shareholder shall decide on the approval of financial statements, the auditor's report and distribution of profit not later than within 4 months after the end of financial year.
- 8.2 In accordance with Article 6.4 c) the Sole Shareholder shall decide on the distribution of profit based on the auditor's report and the profit distribution proposal, prepared by the administrators.

**Article 9
Applicable law**

All matters which are not regulated by these Articles of Association shall be governed by the relevant provisions of the Albanian Commercial Law.

**Article 10
Final Provisions**

- 10.1 Should one or more provisions of these Articles of Association be invalid or shall become invalid for any reason or should these Articles of Association have any gap, this shall not affect the validity of the remaining provisions. The invalid provision shall be substituted for a legally valid provision that is as close as possible to the original intent of the invalid provision; the foregoing also applies with respect to numerical determinations. The Sole Shareholder is obliged to confirm such provision without delay in the necessary form - in any case in writing.
- 10.2 All agreements between the Sole Shareholder and the Company, which concern the Sole Shareholder, must be in writing, unless a different form is required due to mandatory statutory provisions. This also applies to changes to this written form requirement.
- 10.3 These Articles of Association are written in two languages, Albanian and English; in case of discrepancies, the Albanian version shall prevail.

Date: 10.12.2021

For and on behalf of the Sole Shareholder



**Mr. Matthias Kirscht
Managing Director**



**Mr. Lennart Richter
Managing Director**



STATUTI

I

LVM Real Estate Investments Sh.p.k.

("Shoqëria")

Neni 1

Emri, Forma ligjore e Shoqërisë, Selia e Shoqërisë dhe Viti Financiar

- 1.1 Emri i Shoqërisë është **LVM Real Estate Investments Sh.p.k.**
- 1.2 Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me Ligjin 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar ("**Ligji Shqiptar për Shoqëritë Tregtare**").
- 1.3 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: **Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa 32, Hyrja 14, Apartamenti nr. 8, Tiranë, Shqipëri ["Selia e Shoqërisë"]**.
- 1.4 Viti financiar i Shoqërisë fillon më datën 1 Janar dhe mbyllet më datën 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik.
Përfundim bën viti i parë financiar, i cili fillon në momentin e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më datën 31 Dhjetor 2022.

Neni 2

Objekti i Shoqërisë

- 2.1 Objekti i Shoqërisë është si më poshtë:
- a) blerja, shitja, qiradhënia dhe zhvillimi i pasurive të paluajtshme;
 - b) çdo veprimtari që nuk ndalohet me ligj.
- 2.2 Shoqëria ka të drejtë të ndërmarrë të gjitha veprimet dhe masat që janë drejtpërdrejtë ose tërthorazi të përshtatshme për t'i shërbyer objektit të Shoqërisë, duke përfshirë por pa u kufizuar në, themelimin ose blerjen e shoqërive të çdo lloji, pjesëmarrjen në shoqëri apo sipërmarrje të përbashkëta (joint ventures) qoftë shqiptare ose të huaja, ose në lloje të ndryshme aktiviteteve tregtare që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të.
- 2.3 Aktivitetet për të cilat nevojitet marrja e lejeve, licencave dhe/ose miratimeve do të kryhen pasi të merren këto leje, licenca dhe/ose miratime.

Neni 3

Kapitali, Kuotat dhe Ortaku i Vetëm

- 3.1 Kapitali fillestar i Shoqërisë është në vlerën 500.000,00 (pesëqind mijë) Euro të barasvlershme me 60.530.000,00 (gjashtëdhjetë milionë e pesëqind e tridhjetë mijë) Lekë sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë më datë 09.12.2021 në 12:00:39 pasdite (1 Euro = 121,06 Lekë) dhe përbëhet nga 1 (një) kuotë.

Kapitali fillestar do të paguhet në para brenda 6 muajve pas regjistrimit të Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

 1



- 3.2 Ortaku i Vetëm i Shoqërisë është **W E - International Zweite GmbH**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar dhe që ekziston në përputhje me Ligjet e Gjermanisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Shtutgart, me nr. HRB 776225, me zyrë të regjistruar në adresën: Stiftsbergstrasse 1, 74172 Neckarsulm, Gjermani.
- 3.3 Me vendim të Ortakut të Vetëm mund të kryhet zmadhimi i kapitalit, duke rritur vlerën nominale të kuotës ekzistuese ose me çdo formë tjetër të lejuar nga ligji.
- 3.4 Kontributi për kuota mund të jetë në para ose në natyrë. Kontributet në para derdhen në llogarinë bankare të Shoqërisë. Kontributet në natyrë vlerësohen me vendim të Ortakut të Vetëm.

Neni 4 Kohëzgjatja e Shoqërisë

Shoqëria themelohet për një afat të papërcaktuar.

Neni 5 Administratorët dhe Përfaqësimi

- 5.1 Shoqëria ka 2 (dy) administratorë të emëruar nga Ortaku i Vetëm. Shoqëria përfaqësohet nga të 2 (dy) administratorët bashkërisht.

Administratorët e parë të Shoqërisë për një mandat prej 4 (katër) vitesh, duke filluar nga data 10.12.2021, janë si më poshtë:

- **Z. Boris Lozić**, shtetas Kroat, i biri i Hrvoje, lindur më 26.09.1978, në Zlosela, Bosnja dhe Hercegovina mbajtës i pasaportës me nr. 287162801 dhe numër personal 84889031881; dhe
- **Z. Dalibor Bošnjak**, shtetas Kroat, i biri i Marko, lindur më 05.04.1977, në Linz, Austri, mbajtës i pasaportës me nr. 145683301 dhe numër personal 060057669907.

- 5.2 Administratorët kryejnë veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke treguar vigjilencën e një biznesmeni të kujdesshëm dhe duke punuar në mirëbesim dhe në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi. Administratorët në veçanti respektojnë dispozitat e këtij Statuti, dispozitat e rregullores së brendshme të administrimit, vendimet e Ortakut të Vetëm, dispozitat e përcaktuara në kontratat e tyre të punës dhe udhëzimet e dhëna nga Ortaku i Vetëm.
- 5.3 Administratorët mund të autorizojnë bashkërisht, me prokurë, palë të treta që të përfaqësojnë Shoqërinë dhe të nënshkruajnë në emër dhe për llogari të Shoqërisë. Në këto raste, në mënyrë që transaksioni të jetë i vlefshëm, nevojitet edhe nënshkrimi i dytë i njërit prej 2 (dy) administratorëve.

Neni 6 Ortaku i vetëm

- 6.1 Ortaku i Vetëm është përgjegjës për procesin e vendimmarrjes më të lartë të Shoqërisë.
- 6.2 Ortaku i Vetëm mund të përfaqësohet nga këshilltarët ose juristët të cilët kanë marrë përsipër të ruajnë konfidencialitetin profesional në bazë të një autorizimi me shkrim.

 2



Vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm regjistrohen në procesverbalin e mbledhjeve dhe nënshkrimet në procesverbalët përkatës certifikohen në rast se kërkohet noterizim sipas dispozitave ligjore.

Ortaku i Vetëm miraton vendime për çështje të parashikuara nga ligji dhe nga ky statut dhe gjithashtu nëse është e nevojshme në interes të Shoqërisë, në masën e pajtueshme me Ligjin Shqiptar për Shoqëritë Tregtare. Ortaku i Vetëm vendos për çështjet e mëposhtme:

- a) miratimin e raportit vjetor të ecurisë së aktivitetit dhe të pasqyrave financiare vjetore, si dhe shkarkimin e administratorëve;
- b) zgjedhjen e ekspertit kontabël të miratuar për auditimin e bilancit dhe të raporteve vjetore;
- c) vendimin për shpërndarjen e fitimit dhe mbulimin e humbjeve;
- d) vendimet për zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, si dhe për krijimin, përdorimin e synuar dhe shpërndarjen e kapitalit dhe të rezervave të të ardhurave;
- e) shitjen ose dhënien me qira të pasurive të Shoqërisë dhe përcaktimin e të drejtave të përdorimit të tyre;
- f) ndryshimet e Statutit, miratimin dhe ndryshimet e rregulloreve/ marrëveshjeve të partneritetit;
- g) ndryshimin e emrit, selisë dhe objektit të Shoqërisë;
- h) bashkimin, ndarjen ose transformimin e Shoqërisë;
- i) prishjen e Shoqërisë;
- j) emërimin dhe shkarkimin e drejtorëve dhe nëpunësve të shoqërisë;
- k) përgatitjen dhe ndryshimin e rregullores së brendshme për administrimin;
- l) blerjen dhe shitjen e shoqërive ose të pjesëve të shoqërive;
- m) themelimin dhe prishjen e filialeve (subsidiaries), si dhe blerjen, shitjen dhe marrjen e kuotave të shoqërisë;
- n) miratimin e vendimeve të ortakut për filialet e Shoqërisë dhe autorizimin e përfaqësuesit në asambljetë e përgjithshme ku Shoqëria është Ortake, në lidhje me çështje për të cilat kërkohet me ligj vendimi i asamblesë së Shoqërisë;
- o) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykata dhe në procedime të tjera ndaj administratorëve;
- p) çdo çështje tjetër të përcaktuar në Ligjin Shqiptar për Shoqëritë Tregtare.

6.5

Administratorët duhet të kërkojnë miratimin paraprak të shprehur të Ortakut të Vetëm në formën e vendimit me shkrim, për të kryer transaksionet e renditura më poshtë:

3



- a) blerja dhe/ose shitja e titullit ose të drejtave të uzufuktit për truallin ose të drejtës së trashëgueshme mbi truallin, duke përfshirë lidhjen e para-kontratave përkatëse; bën përjashtim këtu blerja e truallit dhe ndërtesave për hapjen dhe operimin e një dyqani, nëse kostot e planifikuara të investimit total për objekt nuk tejkalojnë vlerën e barasvlershme në monedhën vendase të shumës prej 10.000.000,00 (dhjetë milion) Euro, si dhe shitja e truallit me sipërfaqe jo më të madhe se 10,000 m² (dhjetë mijë) metër katror;
- b) lënia peng e pasurisë, veçanërisht me uzufukt, servitut, hipotekë ose vënia e një barre mbi truallin, duke përjashtuar lënien peng në kuadër të rrjedhës normale të veprimtarisë tregtare; veçanërisht, rrjedha normale e veprimtarisë tregtare përfshinë lënien peng të tokës me qëllim:
- lidhjen e kontratave të huasë për nevoja të aktivitetit tregtar të shoqërisë,
 - respektimin e angazhimeve të ndërmarra nga kontratat e blerjes ose nga leja e ndërtimit për të ndërtuar një dyqan,
 - ofrimin e servituteve standarde (standard easements) ose e të drejtave të tjera standarde të përdorimit për shërbimet utilitare të sektorit publik ose privat (p.sh. furnizimi me gaz, ujë dhe energji elektrike, telekomunikacioni);
- c) kryerja e çdo veprimi që lidhet me blerjen ose shitjen e shoqërive ose të pjesëve të shoqërive;
- d) kryerja e çdo veprimi që lidhet me themelimin dhe prishjen e shoqërive dhe me blerjen, shitjen dhe marrjen e kuotave;
- e) lidhja, ndryshimi dhe zgjidhja e marrëveshjeve të shoqërisë, duke përfshirë marrëveshjet për kontrollin dhe transferimin e fitimit dhe humbjes, dhe çdo marrëveshje tjetër të ngjashme me to, sipas ligjit për shoqëritë tregtare (p.sh. marrëveshjet e trustit);
- f) ofrimi i huave, marrja përsipër e garancive dhe detyrimeve të tjera, përveçse në favor të shoqërive të Grupit Schwarz; dhënia e pagesave paradhënie për punëmarrësit bën përjashtim gjithashtu;
- g) kryerja e çdo veprimi të nevojshëm në lidhje me zbatimin e vendimeve për pjesëmarrjen në fitime;
- h) ofrimi i fondeve të pensionit, i fondeve për paaftësi ose për personat në varësi të punëmarrësve që kanë ndërruar jetë;
- i) nënshkrimi i çdo dokumenti që lidhet me vendimet për filialet, në përputhje me nenin 6.4 pikat a) deri në k) dhe pasi të jenë marrë të gjitha miratimet paraprake të nevojshme sipas këtij neni.

Neni 7
Regjistri i Vendimeve

Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen apo tjetërsohen.

Neni 8 Pasqyrat Financiare

- 8.1 Me mbylljen e vitit financiar, administratorët përgatisin menjëherë pasqyrat financiare dhe i'a paraqesin ekspertit kontabël, dhe së bashku me raportin e ekspertit kontabël i'a paraqesin ato Ortakut të Vetëm për miratim. Ortaku i Vetëm vendos për miratimin e pasqyrave financiare, për miratimin e raportit të ekspertit kontabël dhe për shpërndarjen e fitimit, jo më vonë se brenda 4 muajve nga mbyllja e vitit financiar.
- 8.2 Në përputhje me nenin 6.4 pika c), Ortaku i Vetëm vendos mbi shpërndarjen e fitimit në bazë të raportit të ekspertit kontabël dhe në bazë të propozimit për shpërndarjen e fitimit të përgatitur nga administratorët.

Neni 9 Ligji Rregullues

Të gjitha çështjet që nuk rregullohen nga ky Statut do të rregullohen nga dispozitat përkatëse të Ligjit Shqiptar për Shoqëritë Tregtare.

Neni 10 Dispozita Përfundimtare

- 10.1 Në rast se një apo më shumë dispozita të këtij Statuti janë të pavlefshme ose bëhen të pavlefshme për çdo arsye ose nëse ky Statut ka ndonjë mangësi, kjo gjë nuk ndikon në vlefshmërinë e dispozitave të tjera. Dispozita e pavlefshme do të zëvendësohet me një dispozitë ligjore të vlefshme që i përafrohet sa më shumë të jetë e mundur qëllimit fillestar të dispozitës së pavlefshme; sa më lart gjithashtu zbatohet edhe në lidhje me përcaktimet numerike. Ortaku i Vetëm është i detyruar t'a konfirmojë një dispozitë të tillë pa vonesë sipas formës së nevojshme, që në çdo rast duhet të jetë në formë me shkrim.
- 10.2 Të gjitha marrëveshjet mes Ortakut të Vetëm dhe Shoqërisë, që prekin Ortakun e Vetëm, duhet të jenë me shkrim, përveçse kur kërkohet një formë tjetër në bazë të dispozitave të detyrueshme ligjore. Kjo gjithashtu vlen për ndryshimet lidhur me parashikimin për formën me shkrim.
- 10.3 Ky Statut hartohet në dy gjuhë, në shqip dhe në anglisht; në rast mospërputhjeje mes dy versioneve, versioni në shqip do ketë përparësi.

Datë: 10.12.2021

Për dhe në emër të Ortakut të Vetëm

Z. Mathias Kirscht

Administrator

(nënshkrimi)

Z. Lennart Richter

Administrator

(nënshkrimi)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER HELENA B. SHËNGJERGJI(VAKO)



V2022052860001741101

DATE 06/01/2022
NR REP 22



VËRTETIM PËRKTHIMI

Vërtetohet firma e përkthyeses Znj. Daniela Demiri atësia Myzafer, mbajtese e leternjoftimit me nr. personal : banuese në Tiranë, regjistruar ALBA GLOBAL GROUP me Numër NIPT-i K72007001S, e cila më deklaron se përktheu saktësisht sipas dokumentit bashkëngjitur

STATUTI LVM REAL ESTATE INVESTMENTS SHPK DT 10/12/2021

nga gjuha angleze në gjuhën Shqipe dhe e nënshkroi sipas Ligjit, Nr .110, datë 20/12/2018 : “Për noterinë”.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë;” në Republikën e Shqipërisë unë Noterja vërtetohet nënshkrimi i përkthyeses.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

HELENA B. SHËNGJERGJI(VAKO)

Helena Shëngjergji, Vako,

